



Raport vlerësues mbi efektivitetin e EPRBM-ve

Raport i fokusuar në efektivitetin e EPRBM-ve të fëmijët romë, ashkali dhe egjiptian

Raport vlerësues mbi efektivitetin e EPRBM-ve

Ky raport është hartuar nga Mimoza Telaku, me mbështetjen e projektit “Iniciativa e Kosovës për Integrim KOSINT 2020” të financuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, i zbatuar nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Balkan Sunflowers (BSFK), Syri I Vizionit (SiV) dhe Roma and Ashkalia Documentation Center (RADC).

Pikëpamjet e shprehura në këtë vlerësim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal ose pjesëmarrësve të tij, e as të Bashkimit Evropian dhe Fondacionit për Shoqëri të Hapur.

Gusht, 2019

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	3
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	4
TË GJETURAT KYÇE	6
HYRJA	8
STANDARDET NDËRKOMBËTARE	9
KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE	10
Aktet nënligjore për themelimin dhe fuqizimin e EPRBM-ve	11
METODOLOGJIA	15
ANALIZA E FUNKSIONIMIT TË EPRBM-VE	16
Themelimi i EPRBM-ve	16
Identifikimi i rasteve	17
<i>Identifikimi i rasteve të braktisjes</i>	17
<i>Identifikimi i rasteve të mosregjistrimit</i>	18
Referimi, trajtimi dhe monitorimi	20
Regjistrimi i rasteve në modulën e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) në SMIA	22
REKOMANDIMET	24

LISTA E SHKURTESAVE

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
EPRBM	Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MPMS	Ministria e Punës dhe e Mirëqenies sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PK	Policia e Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
SMIA	Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim
SPH	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm
ZKKK	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

E drejta për shkollim është një nga të drejtat themelore të njeriut. Ekzistojnë konventa të ndryshme ndërkombëtare të cilat e garantojnë këtë të drejtë. Në përputhje me këto konventa Qeveria e Kosovës ka zhvilluar politika me anë të të cilave garantohet kjo e drejtë. Megjithatë, braktisja e shkollimit dhe mosregjistrimi në shkollë vazhdon të mbetet në nivelin shqetësues. Sidomos kjo dukuri është më e shprehur në mesin e grupeve të marginalizuara siç janë komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian.

Për t'a adresuar problemin e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka ndërmarrë iniciativën për themelimin dhe fuqizimin e Ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar (EPRBM). Këto ekipe janë themeluar nëpër shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe në ato të mesme të larta, si dhe në nivel nacional në MASHT. Funkionimi i këtyre ekipeve ka hasur në vështirësi, gjë që është reflektuar me vështirësi në parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë.

Për t'a kuptuar më thellë efektivitetin e EPRBM-ve në parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë, gjatë muajit maj dhe qershor 2019 është realizuar një vlerësim në shkolla dhe komuna të ndryshme, si dhe në MASHT.

Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA) dhe shkollat kanë deklaruar që këto ekipe janë tashmë të themeluara në institucionet e tyre. Por funksionalizimi praktik i këtyre ekipeve nuk është në nivelin e duhur për shkak të nivelit tejet të ulët të realizimit të mbledhjeve dhe shqyrtimit të rasteve. Si rrjedhojë, rastet të cilat identifikohen, kryesisht trajtohen jashtë mekanizmave të EPRBM-ve. Andaj, EPRBM-të vazhdojnë të mbeten kryesisht të papërfshira në identifikimin dhe trajtimin e rasteve të braktisjes së shkollimit, rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin dhe rasteve të paregjistruara në shkollë.

Identifikimi i rasteve të braktisjes së shkollimit kryesisht bëhet nga mësimdhënësit në shkolla. Identifikimin e tyre gjithashtu e bëjnë edhe OShC-të të cilat merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe me braktisje të shkollimit. Kryesisht, OShC-të arrijnë të identifikojnë rastet e braktisjes nga raportet e notimit, ku nxënësit që kanë braktisur shkollimin raportohen si të panotuar. Problematike mbetet çështja e raportimit, referimit dhe trajtimit të këtyre rasteve. Nga informatat e mbledhura në terren rezulton që ekzistojnë raste, sidomos në mesin e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët nuk raportohen për braktisjen e shkollimit. Po ashtu, ekzistojnë raste të cilët raportohen me vonesë për braktisjen e shkollimit. Si pasojë, këto raste kryesisht përfundojnë me humbje të vitit shkollor. Ndërsa, identifikimi i rasteve të paregjistruara në shkollë kryesisht bëhet nga OShC-të të cilat merren më çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Problematike mbetet identifikimi i këtyre rasteve në ato zona të cilat nuk janë të mbuluara nga këto OShC.

Rastet braktisjes së shkollimit mund të kenë përfundime të ndryshme. Një pjesë e tyre mund të mbesin të paidentifikuara ose të identifikohen me vonesë. Si pasojë, këto raste zakonisht humbin tërë vitin shkollor dhe nuk u ofrohet mësim i përshpejtuar për të kompenzuar humbjet në mësim. Për këto raste DKA-të zakonisht nuk mbahen të informuara. Rastet e braktisjes së shkollimit në të cilat janë implikuar edhe deliktet referohen në organin e kujdestarisë dhe institucionet tjera të sigurisë dhe drejtësisë. Për këto raste DKA-të zakonisht mbahen të informuara. Rastet e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian referohen te ndërmjetësuesi në komunitet

apo te OShC-të të cilat operojnë në atë zonë dhe që merren me çështje të braktisjes së shkollimit dhe çështje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Shqetësuese mbeten ato zona të cilat nuk kanë mbulueshmëri nga ndërmjetësuesit në komunitet dhe OShC-të përkatëse. Për këto raste DKA-të zakonisht nuk mbahen të informuara.

Është shqetësuese çështja e mosregjistrimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët kanë mbërrirë moshën e paraparë për regjistrim në klasë të parë, por shkolla i konsideron si të “papjekur” në aspektin psikofizik. Këta fëmijë nuk raportohen si braktisës të shkollimit dhe as si raste të paregjistruara në shkollë. Si pasojë, këto raste kryesisht nuk trajtohen dhe humbin së paku një vit shkollor.

Përkundër ekzistimit të një moduli të vecantë në Sistemin për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA), i quajtur Sistemi i paralajmërimit të hershëm (SPH), regjistrimi i ratseve në këtë sistem është tejet minimal. Rastet në rrezik për të braktisur shkollimin pothuajse nuk regjistrohen fare. Në këtë sistem kryesisht regjistrohen vetëm rastet që në trajtimin e tyre është përfshirë organi i kujdestarisë dhe institucionet e tjera relevante të sigurisë dhe drejtësisë. Ndërsa, rastet e tjera të braktisjes së shkollimit dhe rastet e mosregjistrimit në shkollë pothuajse nuk regjistrohen fare.

Përfaqësuesit e institucioneve të cilët janë intervistuar gjatë realizimit të këtij vlerësimi kanë deklaruar që rastet nuk regjistrohen për arsye të: mungesës së njohurive dhe shkathtësive në kompjuter dhe SPH-në të personave përgjegjës, rekrutimit në vazhdimësi të mësimdhënësve dhe drejtorëve, hezitimit për të raportuar rastet në mënyrë që të shmangët imazhi i “shkollës së dështuar” etj.

Për shkak të mungesës së regjistrimit të rasteve, SPH-ja nuk mund të ofrojë ndonjë pasqyrë mbi gjendjen e mosregjistrimit në shkollë, braktisjes së shkollimit dhe rrezikut për braktisje të shkollimit. Aktualisht, SPH-ja mund të ofrojë vetëm një pasqyrë mbi rastet që kanë braktisur shkollimin të cilat në të njëjtën kohë janë trajtuar nga organi i kujdestarisë dhe institucionet relevante të sigurisë dhe drejtësisë.

TË GJETURAT KYÇE

Themelimi i EPRBM-ve

- EPRBM-të janë themeluar në shkollat e arsimit të obliguar dhe në nivel komunal. Themelimi i tyre kryesisht është bërë vetëm administrativisht, ndërsa ende nuk është bërë mjaftueshëm funksionalizimi praktik i tyre.
- Në EPRBM-të komunale mungon përfaqësimi i mjaftueshëm i OShC-ve relevante që merren me çështje të braktisjes së shkollimit.
- Takimet e EPRBM-ve shkollore dhe komunale nuk realizohen sipas dispozitave të udhëzimit përkatës administrativ. Sipas raportimeve të zyrtarëve në terren, këto takime në nivel shkollor nuk realizohen për shkak të mungesës së gatishmërisë së anëtarëve të këtyre ekipeve. Ndërsa, në nivel komunal këto takime nuk realizohen për shkak të numrit të pamjaftueshëm të stafit në DKA për t'u angazhar në iniciativa të ndryshme.
- Shqyrtimi i rasteve nuk bëhet nga EPRBM-të shkollore apo EPRBM-të komunale.
- Në mungesë të realizimit të takimeve, EPRBM-tëshkollore dhe EPRBM-të komunale nuk janë në dijeni për një pjesë të konsiderueshme të rasteve që identifikohen, referohen dhe trajtohen.

Identifikimi i rasteve

- Nuk zbatohen procedura standarde të identifikimit, referimit, trajtimit dhe përcjelljes së rasteve.
- Identifikimi i rasteve të braktisjes së shkollimit kryesisht bëhet në shkolla nga mësuesit duke u bazuar në mungesa të nxënësve. Mirëpo, te rastet që janë identifikuar me vonë ka pasuar humbja e vitit shkollor. Rastet e braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian zakonisht identifikohen në raportet e notave në bazë të mungesës së notimit. Kryesisht ky identifikim inicohet nga OShC-të që merren me çështje të braktisjes së shkollimit dhe me çështje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- Identifikimi i rasteve të mosregjistrimit në shkollë bëhet kryesisht nga OShC-të që merren me çështjet e braktisjes së shkollimit dhe me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në zonat ku nuk operojnë këto OShC, mbetet kritik identifikimi i fëmijëve të paregjistruar në shkollë.
- Shqetësues mbetet niveli i lartë i braktisjeve të përsëritura të shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Referimi dhe trajtimi

Te rastet e braktisjes së shkollimit apo në rrezik për të braktisur shkollimin në mesin e nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian kryesisht praktikohet referimi i tyre te ndërmjetësuesi në komunitet nëse ekziston në atë zonë apo te OShC-të të cilat merren me çështje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian si dhe me çështje të braktisjes së shkollimit. Përndryshe, shkolla kontakton familjen e nxënësit të tillë me anë të telefonit apo forma të tjera alternative. Mbetet çështje kritike mungesa e referimit dhe

trajtimin të mëtejshëm në ato zona ku nuk operojnë ndërmjetësuesit në komunitet apo OShC-të që merren me çështjet e braktisjes së shkollimit dhe me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

- **Shqetësuese mbetet çështja e mosregjistrimit të fëmijëve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët kanë mbërri moshën e paraparë për regjistrim në klasë të parë, por shkolla i konsideron si të “papjekur” në aspektin psikofizik. Këta fëmijë nuk raportohen si braktisës të shkollimit dhe as si raste të paregjistruara në shkollë. Si pasojë, këto raste kryesisht nuk trajtohen.**
- **Trajtimi i rasteve të braktisjes zakonisht fillon brenda shkollës dhe nëse është e nevojshme referohen në organin e kujdestarisë dhe në polici. Mirëpo, shqetësuese mbetet trajtimi i nxënësve braktisës nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këta nxënës, nëse nuk kanë implikime të delikteve, rrallë ndodh që të referohen në shërbimet përkatëse. Referimet më së shpeshti bëhen nga ndërmjetësuesi në komunitet.**

Regjistrimi i rasteve në SPH - SMIA

- **Regjistrimi i rasteve në SPH të SMIA-s është tejet minimal. Në këtë sistem regjistrohen vetëm rastet e rënda, në trajtimin e të cilave përfshihen edhe institucionet e kujdestarisë, sigurisë dhe drejtësisë.**
- **Aktualisht SPH-ja nuk mund të ofroj ndonjë pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së braktisjes së shkollimit, rrezikut për braktisje të shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë.**
- **Nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian të cilët fillojnë klasën e parë, por e ndërprejnë për të rifilluar klasën e parë në vitin pasues nuk regjistrohen në SPH.**
- **Arsyet e raportuara të mosregjistrimit të rasteve në SPH janë: mungesa e njohurive dhe shkathtësive kompjuterike të personave përgjegjës, mungesa e njohurive për SPH-në, rekrutimi i drejtorëve dhe mësimdhënësve të rinjë në shkolla, hezitimi për të regjistruar rastet në mënyrë që të shmanget imazhi i “shkollës së dështuar” etj.**

HYRJA

E drejta për shkollim është e garantuar me konventa të ndryshme ndërkombëtare. Në harmoni me këto konventa institucionet e Kosovës kanë zhvilluar politika të tilla me anë të të cilave synohet të garantohet kjo e drejtë. Në bazë të tyre janë themeluar mekanizma institucional për të arritur shkollimin e të gjithë fëmijëve në Kosovë. Megjithatë, braktisja e shkollës dhe mosregjistrimi në shkollë vazhdon të jetë prezent në shoqërinë kosovare.

Përkundër ekzistimit të këtyre mekanizmave, dukuria e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë vazhdon të mbetet në nivelin shqetësues. MASHT-i raporton që në vitin shkollor 2017/2018¹:

- në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët 0.1% e nxënësve kanë braktisur shkollimin në përqindje të barabarta për të dy gjinitë
- në arsimin e mesëm të lartë kanë braktisur shkollimin gjithsej 1.8% e nxënësve, ku 2.8% janë meshkuj dhe 0.8% janë femra
- shkalla e tranzicionit nga arsimit fillor në atë të mesëm të ulët është 99.4% në total, ku 99.3% janë meshkuj dhe 99.5% janë femra
- Shkalla e tranzicionit nga arsimit i mesëm i ulët në arsimin e mesëm të lartë është 96.4% në total, ku 99.5% janë meshkuj dhe 93.3% janë femra.

Ndër kategoritë më të prekura nga kjo dukuri janë fëmijët e grupeve të marginalizuara. Dysohet që përqindja më e lartë e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë është në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe në mesin e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Sipas MASHT-it, rreth 5% e fëmijëve në Kosovë nuk figurojnë në sistemin arsimor. Përveç kategorive të përmendura, në këtë përqindje hyjnë edhe fëmijët të cilët kanë migruar, fëmijët të cilët janë transferuar në shkolla apo komuna tjera etj. Braktisja e shkollimit dhe mosregjistrimi në shkollë është më i lartë në mesin e nxënësve në shkollat e mesme të larta. Sipas zyrtarëve të DKA-ve dhe të MASHT-it, dhe përfaqësuesvetë OShC-ve, niveli më i lartë i braktisjes në shkolla të mesme ndodhë si pasojë e angazhimit të nxënësve në punë, orientimit jo të duhur profesional, ndikimi i rrethit dhe familjes në përzgjedhjen e drejtimit jo të duhur të shkollimit, regjistrimi i pavullnetshëm në drejtim të padëshiruar në shkollë të mesme të lartë etj.

Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) ka ndërmarrë një iniciativë për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar. Këto ekipe janë themeluar në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta, komuna dhe në MASHT. Funksionimi i tyre ka hasur në vështirësi, gjë që është reflektuar edhe në përpjekjet për parandalimin e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë.

Sipas statistikave të MASHT-it dhe Agjencisë së statistikave të Kosovës (ASK), në sistemin e arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2017/2018 janë gjithsej 365029 nxënës: 6636 në

¹ Raport vjetor statistikor me tregues arsimorë 2017/2018. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
<http://masht-smia.net/Publikimet/35ALB.pdf>

shkollimin parashkollor, 24002 në shkollimin parafillor, 244677 në shkollën fillore dhe të mesme të ulët dhe 89714 në shkollën e mesme të lartë. Sipas përkatësisë etnike, në vitin shkollor 2017/2018 janë: 350273 shqiptarë, 3965 boshnjakë, 2002 romë, 939 egjiptianë, 3729 ashkalinj, 2756 turq, 557 goranë, 26 kroatë, 500 serbë (vetëm në disa shkolla të Komunës së Kamenicës), dhe 282 të përkatësive të tjera etnike.²

STANDARDET NDËRKOMBËTARE

E drejta për shkollim pa diskriminim është e garantuar me konventa ndërkombëtare. Konventa e UNESCO-s kundër diskriminimit në shkollim (1960) ndalon përjashtimin nga mundësia për shkollim në bazë të origjinës sociale, përkatësisë etnike, gjuhës, gjinisë, nacionalitetit, gjendjes ekonomike etj. Kjo konventë promovon sistem shkollor gjithëpërfshirës i cili largon barrierat që pengojnë pjesëmarrjen dhe arritjet e të gjithë individëve, respekton nevojat, aftësitë dhe karakteristikat e ndryshme, si dhe eliminon të gjitha format e diskriminimit në ambientet ku zhvillohet mësimi.

Deklarata dhe Korniza e Incheon-it për Veprim (Shkollimi 2030) për zbatimin e Qëllimit numër 4. të Zhvillimit të Qëndrueshëm nënshkruar në 2015 në Forumin Botëror të Shkollimit. Kanë marrë pjesë mbi 1600 pjesëmarrës nga 160 shtete. Kjo deklaratë ka vendosur vizionin e ri për shkollim për pesëmbëdhjetë vitet e ardhshme. Në mes tjerash, kjo deklaratë parasheh: sigurimin e qasjes në shkollim dhe përfundimin shkollimit për të gjithë për së paku 12 vite shkollim fillor dhe të mesëm në shkollat publike, shkollim cilësor të barabartë dhe gjithëpërfshirës, si dhe promovim të mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë pa dallime. Gjithashtu, për të adresuar të gjitha format e përjashtimit dhe marginalizimit, kjo deklaratë parasheh ndryshimet e nevojshme në politika të arsimit, me një fokus të veçantë në grupet e cënueshme.³

Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare përfshinë udhëzimet për shkollimin e pakicave në gjuhën e tyre amtare dhe përfshirjen e mësimëve për historinë, kulturën dhe traditat e pakicave në fjalë. Për të realizuar këtë parashihet që shtetet të themelojnë qendra për zhvillimin e planprogrameve mësimore të pakicave në gjuhën e tyre.⁴

² Të dhëna mbi arsimin: shënime statistikore 2017/2018-Arsimi parauniversitar. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë <http://masht-smia.net/Publikimet/32ALB.pdf>

³ Education 2030: Incheon Declaration and Framework for Action for the implementation of Sustainable Development Goal 4: Ensure inclusive and equitable quality education and promote lifelong learning opportunities for all <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000245656>

⁴ Rekomandimet e Hagës lidhur me të drejtat e shkollimit të pakicave kombëtare & sqarime. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) <https://www.osce.org/sq/hcnm/32181?download=true>

KORNIZA LIGJORE DHE STRATEGJIKE

Përfshirja e grupeve të përjashtuara dhe të marginalizuara, si dhe ofrimi i një shkollimi cilësor për këto grupe parashtron nevojën e zhvillimit dhe zbatimit të politikave dhe programeve gjithëpërfshirëse. Duke u bazuar në standarde ndërkombëtare, Qeveria e Kosovës ka zhvilluar politika të tilla që janë në harmoni me këto standarde. Ekziston një mori e ligjeve të cilat prekin në mënyrë direkte ose indirekte çështjen e promovimit dhe përfshirjes së të gjitha komuniteteve në shkollim.

Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në nenin tetë (8) për arsimimin garanton që “të gjithë personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë të marrin shkollim publik në të gjitha nivelet, në njërin nga gjuhët zyrtare të Kosovës që ata e zgjedhin. Personat që iu përkasin komuniteteve kanë të drejtë në shkollim publik parashkollor, fillor dhe të mesëm në gjuhën e tyre edhe nëse ajo nuk është gjuhë zyrtare”.⁵

Ligji për përdorimin e gjuhëve siguron të drejtën për çdo person që të zgjedhë për vete ose për fëmijën e vetë gjuhën e vetë të preferuar zyrtare për mësim. Në zonat e banuara me persona që i takojnë komunitetit, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare, personat që i takojnë këtij komuniteti kanë të drejtë të mësojnë në gjuhën e tyre amtare në shkollat publike arsimore.⁶

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi përkufizon diskriminimin si “çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose çënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës”. Një nga fushëveprimet e këtij ligji është edhe arsimimi.⁷

Ligji për arsimin në komuna rregullon kompetencat e komunave në nivelet 0, 1, 2 dhe 3 të arsimit publik (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë), ku në mes tjerash specifikon kompetencën e komunave në regjistrimin dhe pranimin e nxënësve në përputhje me respektimin e duhur tëparimeve të mosdiskriminimit sipas ligjit, si dhe monitorimin dhe raportimin tek prindërit apo autoritetet e tjera përgjegjëse të vijueshmërisë arsimore dhe sociale të nxënësve, ashtu siç përcaktohet nga legjislati.⁸

⁵Ligji nr. 03/L-047: Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

⁶Ligji nr. 02/L-37: Ligji për përdorimin e gjuhëve <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

⁷Ligji nr. 05/L-021: Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10924>

⁸Ligji nr. 03/L-068: ligji për arsimin në komunat e republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2543>

Aktet nënligjore për themelimin dhe fuqizimin e EPRBM-ve

MASHT-i në vitin 2012 ka nxjerr udhëzimin administrativ nr. 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar (EPRBM).⁹

Sipas këtij udhëzimi, roli i EPRBM-ve konsiston në:

- a) parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së mësimit të rregullt në shkollimin e obliguar nga nxënësit
- b) problemi i mosregjistrimit të fëmijëve dhe të rinjve të moshës shkollore në arsimin e obliguar.

Gjithashtu, ky udhëzim administrativ parasheh dispozitat për themelimin e EPRBM-ve në nivel shkolle të arsimit të obliguar dhe në nivel komunal.

Për dallim nga udhëzimi administrativ i lartpërmendur, udhëzimi administrativ nr. 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar¹⁰ parasheh themelimin e EPRBM-ve jo vetëm në nivel shkolle të arsimit të obliguar dhe në nivel komune (DKA), por edhe në nivel shkolle të arsimit të mesëm të lartë dhe në nivel nacional (MASHT). Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi administrativ në vitin 2018 është shfuqizuar udhëzimi administrativ nr. 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar.

Të dy udhëzimet administrative të lartcekura e definojnë nxënësin braktisës si në vijim:

- a) Braktisës është ai nxënës i cili ndërpret shkollimin para përfundimit të arsimit të obliguar me ligj.
- b) Braktisës është ai nxënës i cili edhe pas mbarimit të arsimit të obliguar e vazhdon shkollimin, por e ndërpret atë në një periudhë të mëvonshme, para përfundimit të synuar.
- c) Braktisës është edhe ai fëmijë ose i ri i cili nuk është regjistruar në shkollë dhe nuk ndjek arsimin e obliguar me ligj.

Vlen të theksohet që parimet në të cilat duhet të bazohet puna e EPRBM-ve sipas këtij udhëzimi kanë një rëndësi kryesore për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Këto parime të cekura në këtë udhëzim administrativ janë si në vijim:

- a) barazia
- b) pjesëmarrja dhe gjithëpërfshirja

⁹Udhëzimin administrativ nr. 19/2012 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8222>

¹⁰Udhëzimi administrativ nr. 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/06/8-ua-masht-nr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdhe-kbmnapu.pdf>

- c) mosdiskriminimi
- d) mbijetesa dhe zhvillimi

Dispozitat e udhëzimit administrativ të hyrë në fuqi në vitin 2018 për EPRBM-të në nivel të shkollës përfshijnë:

- a) Këshilli drejtues i shkollës themelon EPRBM-në në nivel të shkollës, i cili do të ketë pesë anëtarë të rregullt: drejtori i shkollës, një përfaqësues i nxënësve, një përfaqësues i prindërve, një përfaqësues i mësimeve të mësimdhënësve. Sipas nevojës, EPRBM-ja mund të vendos të integrojë ekspertë shtesë.
- b) Për të gjitha rastet e identifikuara dhe të iniciuara, menaxheri përkatës raporton para grupit çdo tre muaj dhe sipas nevojës lidhur me zhvillimin e trajtimit të rastit të caktuar.
- c) EPRBM-ja e shkollës i raporton EPRBM-së në nivel të komunës (DKA) çdo gjashtë muaj dhe sipas nevojës rreth punës së grupit.

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ për EPRBM-të në nivel të komunës përfshijnë:

- a) DKA-ja themelon EPRBM-në në nivel të komunës, i cili përbëhet nga 9 anëtarë: dy përfaqësues nga DKA-ja, një përfaqësues nga Këshilli i prindërve, një përfaqësues i Këshillit të nxënësve, një drejtor shkolle, nga një përfaqësues i drejtorive për mirëqenie sociale, shëndetësisë, Zyrës komunale për komunitete dhe kthim (ZKKK), shoqërisë civile që ka ekspertizë në fushën e gjithëpërfshirjes në arsimin cilësor.
- b) EPRBM-ja komunale takohet çdo tre muaj e sipas nevojës, për të shqyrtuar dhe trajtuar të gjitha rastet që i referohen nga shkollat.
- c) Ekipi i komunës i raporton drejtorit komunal të arsimit çdo tre muaj dhe sipas nevojës.
- d) Kryesuesi i EPRBM-së komunale i informon ekipet shkollore mbi ecurinë e trajtimit të rasteve konkrete.
- e) EPRBM-ja komunale i raporton EPRBM-së në nivel të MASHT-it.

Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ për EPRBM-në në MASHT përfshijnë:

- a) MASHT-i themelon EPRBM-në në nivel qendror me këtë përfaqësim: MASHT, DKA, shkollë, Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (MPMS), Ministria e drejtësisë (MD), Ministria e shëndetësisë (MSh), Policia e Kosovës (PK), Këshilli prokurorial i Kosovës (KPK), partnerët zhvillimorë dhe grupet tjera të interesit.
- b) EPRBM-ja në nivel qendror udhëhiqet nga MASHT-i dhe përfaqësohet nga përfaqësues të sektorëve relevantë përgjegjës për adresimin e të drejtës për arsim.
- c) EPRBM-ja në nivel qendror harton dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin parauniversitar.

Për dallim nga udhëzimi administrativ paraprak, udhëzimi administrativ i hyrë në fuqi në vitin 2018 parasheh dispozitat për modulën e Sistemit të paralajmërimit të hershem (SPH) në Sistemin për menaxhimin e informatave në arsim (SMIA). Ky është një modul i veçantë në SMIA, i cili:

- a) gjeneron informacion mbi rastet në rrezik të braktisjes, të cilat i identifikojnë, raportojnë dhe trajtojnë shkollat në përditshmëri.
- b) ndërlidh informatën nga shkolla, DKA-ja dhe MASHT-i, duke ofruar informacione sasiore e cilësore dhe indikacione për situatën në terren dhe mundësi për orientimin e politikave në të gjitha nivelet: shkollë, DKA dhe MASHT.
- c) korrespondon dhe i kontribuon me informacion edhe modulit e regjistrimit të rasteve të dhunës në shkolla.
- d) Shkollat obligohen që rastet e identifikuara në rrezik të braktisjes t'i regjistrojnë në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH) dhe t'i mbajnë përgjegjëse institucionet relevante që figurojnë në sistem të referimit dhe trajtimit të rasteve.
- d) Për futjen e të dhënave në SPH, është përgjegjës drejtori i shkollës dhe qasje në sistem mund të kenë personat e autorizuar nga drejtori (anëtarë të EPRBM-së).

Ky udhëzim administrativ parasheh masa ndëshkuese dhe disiplinore në përputhje me legjislacionin në fuqi për moszbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë udhëzim administrativ.

Krahas ligjeve dhe akteve nënligjore, institucionet përkatëse kanë përpiluar strategjitë dhe planet e veprimit të cilat përfshijnë adresimin e çështjes së braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në arsim, si dhe përfshirjen e grupeve të marginalizuara.

Një nga objektivat e Planit strategjik të arimit në Kosovë 2017-2021¹¹ përfshinë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen. Ndër rezultatet e pritshme, ky plan strategjik përfshinë:

- Përfshirja e fëmijëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin fillor të rritet për 10%, ndërsa në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë për 20%;
- Të ekzistojnë mekanizma efektivë për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë në arsimin parauniversitar;
- Të ekzistojnë mekanizma e politika efektive të krijuara për promovimin e diversitetit përmes një sistemi të integruar arsimor.

Qendrat mësimore të cilat funksionojnë nën menaxhim të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile (OSHC-të) operojnë me programe të ndryshme mësimore. Kjo strategji ka paraparë harmonizim të këtyre programeve dhe përshtatje të tyre ndaj nevojave të komunitetit.

Për të tejkaluar vështirësitë në regjistrim dhe vijim të shkollimit të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në arsimin parauniversitar janë paraparë masa lehtësuese me anë të

¹¹Plani Strategjik i Arimit në Kosovë 2017-2021 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

këtij plani strategjik. Përveç kësaj, janë paraparë aktivitete vetëdijesuese për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian për regjistrim me kohë dhe vijim të shkollimit.

Gjuha rome, gjithashtu, ka zënë vend në këtë plan strategjik në mënyrë që të sigurohet ofrimi i mësimi zgjedhor i gjuhës rome.

Sa i përket funksionimit të mekanizmave, ky plan strategjik ka paraparë mekanizma efektivë për parandalim të braktisjes dhe mosregjistrimiti në shkollë. Për këtë ka paraparë ngritjen e kapaciteteve të EPRBM-ve në shkollë, komunë dhe në nivelin qendror, si dhe shtrirjen e EPRBM-ve edhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë. Po ashtu, është paraparë krijimi i planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat, si dhe ofrimi i mësimi të përshpejtuar për nxënësit që kanë braktisur ose nuk janë regjistruar në shkollë.

Një aspekt i rëndësishëm i paraparë në këtë strategji është përmirësimi i grumbullimit të të dhënave. Kjo do të kontribuonte dukshëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave përkatëse.

Ngjashëm me Planin Strategjik të Arimit në Kosovë 2017-2021, Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021 synon rritjen e përfshirjes dhe ofrimin e mundësive për zhvillim, aftësim dhe arsim cilësor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali me anë të:

- Stimulimit të vijimit të edukimit parashkollor
- Hartimit të planeve të veprimit për parandalimin e braktisjes dhe të mosregjistrimit në të gjitha komunat
- Masave stimuluese për lehtësimin e regjistrimit dhe vijimit të fëmijëve rom dhe ashkali në arsimin e mesëm të lartë
- Hartimit të planeve individuale për nxënësit e ri-atdhesuar rom dhe ashkali
- Zhvillimit të masave të veçanta pozitive dhe i programeve përgatitore për regjistrimin dhe mbajtjen e studentëve në Institucionet e arsimit të lartë (IAL) nga radhët e komuniteteve rom dhe ashkali
- Mbështetjes së programeve për arsimimin e të rriturve
- Përcaktimit të treguesve të ndjeshëm gjinor për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe ashkali për SMIA
- Eliminimit të segregacionit dhe diskriminimit ndaj fëmijëve të komuniteteve rom dhe ashkali.
- Mbështetjes së qendrave mësimore me bazë në komunitet
- Ofrimin të mësimi plotësues për nxënësit që ngecin në mësim
- Promovimit të mësimi të gjuhës rome
- Zhvillimit të programeve për vetëdijësimin e prindërve lidhur me fëmijërinë e hershme
- Organizimit të aktiviteteve për vetëdijësimin e komuniteteve rom dhe ashkali për rëndësinë e regjistrimit me kohë dhe vijimin e shkollimit, me fokus të veçantë tek vajzat
- Vetëdijësimin të popullatës për arsimimin e komuniteteve rom dhe ashkali.¹²

¹²Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021
<http://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/ALB->

METODOLOGJIA

Qëllimi i këtij raporti është vlerësimi i efektivitetit të EPRBM-ve në nivel shkollor, komunal dhe nacional, me një fokus të veçantë në efektivitetin e tyre te fëmijët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Pjesa fillestare e këtij raporti ka të bëjë me shqyrtimin e standardeve ndërkombëtare dhe kornizës ligjore nacionale që përfshin: të drejtat e fëmijëve për shkollim, parandalimin e braktisjes dhe reagimin ndaj mosregjistrimit në shkollim, përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe promovimin e diversitetit. Krahas këtyre, janë analizuar aktet nënligjore dhe strategjitë relevante të cilat specifikojnë rolin e EPRBM-ve.

Pjesa pasuese e realizimit të këtij raportimi ka të bëjë me mbledhjen e informatave nga terreni. Për këtë janë përfshirë tri komuna në regjione të ndryshme: Ferizaj, Fushë Kosovë dhe Prizren. Gjithashtu, është përfshirë edhe niveli qendror dhe OShC-të. Informatorët e përfshirë në realizimin e këtij vlerësimi kanë qenë përfaqësues nga:

- shkollat
- drejtoritë komunale të arsimit (DKA-të),
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)
- OShC-të

Në nivel të shkollave janë intervistuar drejtorët e shkollave të cilët kanë ofruar informata të dorës së parë në lidhje me mënyrën e funksionimit të EPRBM-ve shkollore. Në nivel të komunave janë intervistuar zyrtarët e DKA-ve të cilët janë të përfshirë direkt në përbërjen e EPRBM-së komunale. Në nivel qendror është intervistuar zyrtarja nga MASHT-i e cila njëkohësisht është e përfshirë në strukturën përbërëse të EPRBM-së në MASHT. Po ashtu, janë intervistuar përfaqësuesit e OJQ-ve që merren në mënyrë direkte në adresimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të fëmijëve në shkollim.

Mbledhja e informatave kryesisht është bazuar në dispozitat e udhëzimit administrativ nr. 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar, termat e referencës së EPRBM-ve shkollore dhe EPRBM-ve komunale, Planin strategjik të arsimit në Kosovë 2017-2021 dhe Strategjinë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021. Temat kryesore të intervistave kanë përfshirë:

- themelimin e EPRBM-ve në nivel shkolle, komunal (DKA) dhe nacional (MASHT)
- funksionimi i EPRBM-ve
- identifikimi i nxënësve braktisës
- identifikimi i rasteve të paregjistruar në shkollë
- trajtimi i rasteve të paregjistruara në shkollë, rasteve të braktisjes së shkollimit dhe rasteve në rrezik për braktisje të shkollimit
- mënyra e referimit dhe përcjelljes së këtyre rasteve

- dokumentimi i identifikimit, trajtimit, referimit dhe përcjelljes së këtyre rasteve
- shfrytëzimi i SPH.

Mënyra e mbledhjes së informatave ka konsistuar në intervista individuale me informatorët e lartpërmendur. Për këtë raport janë shfrytëzuar të dhëna statistikore nga Agjencia e statistikave të Kosovës (ASK). Këto të dhëna kanë të bëjnë me numrin e nxënësve sipas përkatësisë etnike në nivel të Kosovës dhe në nivel komunal.

Mbledhja e të dhënave dhe informatave është realizuar gjatë muajit maj dhe qershor 2019.

ANALIZA E FUNKSIONIMIT TË EPRBM-VE

Themelimi i EPRBM-ve

Gjatë realizimit të këtij vlerësimi, zyrtarët e DKA-ve të komunave të kontaktuar kanë deklaruar që EPRBM-të janë të themeluara në nivel komunal. Mirëpo, vetëm komuna e Fushë Kosovës ka ofruar dokumentacionin përkatës për themelimin e EPRBM-së në nivel komunal.

Zyrtarët e DKA-ve dhe të shkollave kanë deklaruar që EPRBM-të janë të themeluara edhe në nivel të shkollave. Përveç shkollave fillore, EPRBM-të kanë filluar të themelohen edhe në shkollat e mesme.

Vlen të theksohet që lista e anëtarëve të EPRBM-ve nuk përditësohet me anëtarët e rinj që bëhen pjesë e këtyre ekipeve, si dhe nuk nxirren vendime të reja të themelimit të EPRBM-ve pas skadimit të mandatit të tyre.

Realizimi i takimeve të EPRBM-ve komunale dhe shkollore nuk realizohet ashtu siç përcaktohet me udhëzimin administrativ nr. 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar. Përgjegjësit në DKA raportojnë që realizimi i takimeve të rregullta është shumë i vështirë dhe shpeshherë i pamundur për shkak të numrit të kufizuar të stafit në DKA. Ata theksojnë që ekzistojnë shumë iniciativa dhe projekte në të cilat këto drejtori janë të përfshira sa që nuk premtan koha për t'u angazhuar stafi i këtyre drejtorive në të gjitha këto iniciativa dhe projekte ashtu siç kërkohet. Anëtarët e EPRBM-ve komunale nga institucionet tjera deklarojnë që kurrë nuk janë ftuar nga DKA-ja për ndonjë takim të EPRBM-së komunale.

Në nivelin e shkollave, zyrtarët përgjegjës raportojnë që takimet e EPRBM-ve është vështirë të realizohen për shkak të mungesës së gatishmërisë së anëtarëve të EPRBM-ve shkollore për të realizuar takimet dhe ndjekur procedurat ashtu siç kërkohet me udhëzimin administrativ përkatës. Këta anëtarë konsiderojnë që ky është një angazhim shtesë që i ngarkon në punën e tyre dhe që nuk kompensohen materialisht për këtë angazhim shtesë. Përveç kësaj, ata konsiderojnë që ky është një problem që duhet të merren organet kompetente me problemet e

të miturve siç është Qendra për punë sociale (QPS). Sa i përket çështjes së braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë të fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, anëtarët e EPRBM-ve shkollore konsiderojnë që kjo është një çështje kulturore e këtyre komuniteteve etnike dhe EPRBM-të nuk janë kompetentë që të adresojnë këtë problem.

Andaj, në bazë të informatave të mbledhura në terren rezulton që EPRBM-të, sidomos EPRBM-të shkollore janë themeluar vetëm administrativisht. Raportimi i rastit të braktisjes ose në rrezik për braktisje të shkollimit bëhet individualisht nga mësimdhënësi apo kujdestari i klasës përkatëse te drejtori i shkollës. Për adresim të rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian zakonisht praktikohet që rasti të referohet te ndërmjetësuesi në komunitet (nëse ekziston në atë shkollë) dhe në QPS. Zakonisht EPRBM-ja shkollore nuk është në dijeni për procedimin/trajtimin e rasteve të braktisjes apo në rrezik për braktisje.

Identifikimi i rasteve

Në ligjin për arsimin parauniversitar braktisja e shkollës përkufizohet si “ndërprerje e parakohshme e shkollimit të detyruar”.¹³ Udhëzimi administrativ nr. 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar specifikon kategoritë e braktisjes. Mirëpo, as ligji për arsimin parauniversitar dhe as udhëzimi administrativ nr. 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në arsimin parauniversitar nuk e përfshinë braktisjen e përkohshme të shkollimit.

Identifikimi i rasteve të braktisjes

Për dallim nga identifikimi i rasteve të mosregjistrimit në shkollë, identifikimi i rasteve të braktisjes së shkollimit apo rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin është më pak problematik. Zakonisht, identifikimi i rasteve të braktisjes apo në rrezik për të braktisur shkollimin bëhet nga vetë shkolla. Fillimisht, janë mësimdhënësit të cilët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me nxënësit dhe janë personat e parë të cilët e vërejnë mosvijueshmërinë e nxënësve në klasë. Nuk ka ndonjë kriter se pas sa kohe të mosvijueshmërisë së nxënësit mësimdhënësi duhet të raportoj rastin. E gjithë kjo varet nga gjykimi individual i mësimdhënësit se kur rasti mund të jetë potencial për braktisje të shkollimit.

Në mesin e nxënësve, sidomos nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, ka mosvijueshmëri të rregullt të mësimin për arsye të ndryshme:

- Mungesa e mbikëqyrjes së fëmijëve nga prindërit, për fëmijët paraqet një rrethanë të favorshme për të neglizhuar vijimin e mësimin.

¹³Neni 2 i paragrafit 1.13 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011, http://www.mashtgov.net/advCms/documents/03_Ligji_per_arsimin_Parauniversitar_anglisht.pdf

- Obligimet familjare të fëmijëve për të ofruar përkujdesje, sidomos të vajzave për përkujdesje ndaj anëtarëve të sëmurë të familjes, pamundëson vijimin e rregullt të mësimin për aq sa zgjatë gjendja e vështirë shëndetësore e anëtarit/anëtarëve të familjes.
- Vizitat e nënave në farefis së bashku me fëmijët për ditë apo javë të tëra pamundësojnë vijimin e shkollës për aq sa zgjatë vizita.
- Angazhimi i fëmijëve në punë pamundësojnë në mënyrë direkte vijimin e mësimin për aq sa janë duke punuar ose në mënyrë indirekte duke shkaktuar lodhje dhe mungesë energjie për të shkuar në shkollë.
- Shpërblimet materiale për vijueshmëri në shkollë nga institucione/organizata të ndryshme kanë krijuar varësi në ato shpërblime materiale. Në rast të ndërprerjes së atyre shpërblimeve nxënësit ndërpresin vijimin e shkollimit.

Këta shembuj të shkaktarëve të mosvijueshmërisë së rregullt tënxënësve shkaktajnë konfuzion në kategorizimin e rasteve si raste të braktisjes apo raste në rrezik të braktisjes së shkollimit. Kushtimisht, këto raste mund t'i quajmë "braktisës recidiv". Kjo ndikon gjithashtu edhe në raportimin e rasteve nëSPH të SMIA-s dhe në EPRBM-në komunale. Shpesh këto raste nuk regjistrohen nëSPH të SMIA-s dhe nuk raportohen në EPRBM-në komunale. Zakonisht, këto raste mbesin të panotuar, si dhe nuk raportohen si braktisës të shkollimit apo si raste në rrezik për braktisje të shkollimit. Rrjedhimisht, trajtimi dhe monitorimi i tyre mund të mos jetë adekuat dhe mund të çojë në recidiva të mëtutjeshme të braktisjes së shkollimit.

Në shkolla, rastet e konsideruara si potenciale për braktisje të shkollimit, mësimdhënësit i lajmërojnë gojarisht ose me shkrim te drejtori i shkollës. Për vlerësim dhe trajtim të rastit nuk ndiçet ndonjë procedurë standarde e vlerësimit dhe trajtimit të rastit. Më së shpeshti praktikohet kontaktimi me telefon i familjes së fëmijës që supozohet të jetë braktisës dhe biseda me nxënësit e tjerë në klasë apo në shkollë të cilët potencialisht mund të ofrojnë informata mbi nxënësinë fjalë. Këtë e bën mësuesi apo kujdestari i klasës përkatëse. Te rastet e nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian praktikohet kontaktimi i ndërmjetësuesit në komunitet nëse është në dispozicion në shkollën përkatëse. Ndërmjetësuesi zakonisht bënë vlerësimin e rastit me anë të vizitave në terren/familje dhe përpiqet që të rikthejë në shkollënxënësin i cili konsiderohet si braktisës i shkollimit.

Identifikimi i rasteve të mosregjistrimit

Identifikimi i rasteve të mosregjistrimit është mëproblematic. Për identifikimin e këtyre rasteve nevojitet angazhimi i akterëve të ndryshëm nga institucionet shkollore dhe institucionet tjera, OShC-të dhe komuniteti. Rol kyç në identifikimin e fëmijëve të paregjistruar në shkollë kanë OShC-të. Sidomos këtë rol kyç e luajnë ato organizata të cilat aktivitetin e tyre kanë përqendruar në komunitet, dhe më specifikisht në komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Këto organizata, të cilat shpesh nuk përfaqësohen në EPRBM-të komunale, bëjnë kampanja vetëdijesuese për informimin e komunitetit për domosdoshmërinë e regjistrimit të fëmijëve nëshkollë. Në të njëjtën kohë, disa organizata të tilla praktikojnë që me anë të aktiviteteve të tyre në komunitet të identifikojnë fëmijët të cilët janë në moshë të vijimit të shkollimit, mirëpo nuk janë të regjistruar në shkollë. Në këtë mënyrë përpilojnë listat e këtyre fëmijëve dhe i krahasojnë me listat e nxënësve të regjistruar në shkollat të cilat kanë mbulueshmëri në atë zonë. Fëmijët të cilët nuk

figurojnë në listat e nxënësve të regjistruar në shkollë asistohen nga këto organizata për t'u regjistruar në shkollë.

Gjithashtu, këto organizata identifikojnë barriera të ndryshme të cilat pamundësojnë regjistrimin e fëmijëve në shkollë p.sh. mungesa e dokumentacionit për shkak të mosregjistrimit të fëmijës në regjistrin civil, mungesa e dokumentacionit përkatës të shkollimit paraprak të fëmijët e riatdhesuar, fëmijët e prindërve të sëmurë, etj. Këto organizata asistojnë në tejkalimin e këtyre barrierave dhe regjistrimin e tyre në shkollë.

Mirëpo, këto organizata nuk e mbulojnë tërë territorin e Kosovës me aktivitetet e tyre. Aq më tepër nuk i mbulojnë të gjitha zonat në të cilat jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo nënkupton që ekzistojnë zona të cilat nuk marrin asistencë të tillë dhe rrjedhimisht niveli mosregjistrimit mund të jetë prezent në shkallë të lartë.

Një problem shqetësues është mosregjistrimi i fëmijëve të cilët e kanë arritur moshën për regjistrim në klasë të parë, mirëpo konsiderohen si të "papjekur" për të filluar vijimin e shkollimit në klasë të parë. Këta fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian stafi në shkolla i konsideron si të papjekur në aspektin psiko-fizik për të filluar shkollimin në klasën e parë. Ka fëmijë të cilët kanë vështirësi emocionale dhe sociale për t'u adaptuar në shkollë gjatë ditëve apo javëve të para të klasës së parë. Gjendja e tillë emocionale e këtyre fëmijëve mund të përkeqësohet nga qasja joadekuate e mësimdhënësit. OShC-të relevante raportojnë që qasja emësimdhënësve ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian nuk është e njëjtë me qasjen ndaj nxënësve të komuniteteve tjera. Ndodh shpesh që mësimdhënësit të mos përkushtohen ndaj nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ashtu siç përkushtohen ndaj nxënësve të komuniteteve tjera. Po ashtu, ndodh shpesh që nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të mos inkurajohen për t'u angazhuar në aktivitetet brenda klasës dhe shkollës. Si pasojë e qasjes joadekuate, këta nxënës bëhen potencial për neglizhim të mësimnxënies dhe mosvijueshmëri të rregullt të mësimin.

Këta fëmijët e cilët kanë vështirësi në adaptim në klasën e parë rekomandohen që të presin edhe një vit që të fillojnë klasën e parë. Rrjedhimisht, shtyrja e fillimit të klasës së parë paraqet huti në identifikimin dhe kategorizimin e tyre. Këta fëmijë shkolla i konsideron si jobraktisës për shkak se konsideron që nuk e kanë arritur pjekurinë e duhur për t'u regjistruar në klasë të parë. Ndërsa, OShC-të i konsiderojnë këta fëmijësi braktisës për shkak se këta fëmijë e kanë arritur moshën eregjistrimit në shkollë por nuk e vijnë shkollimin. Në anën tjetër, këtyre fëmijëve nuk iu bëhet vlerësimi i pjekurisë nga profesionistët e fushës përkatëse p.sh. psikologë, mjekë, etj. Në të shumtën e rasteve, rastet e këtyre fëmijëve nuk regjistrohen si braktisës në SPH të SMIA-s. Kjo praktikë krijon një boshllëk i cili reflektohet në politikat komunale dhe nacionale duke anashkaluar adresimin e çështjes së këtyre fëmijëve në mungesë të mbledhjes sistematike të informatave.

Referimi, trajtimi dhe monitorimi

Jo të gjitha shkollat i trajtojnë të gjitha rastet në rrezik për braktisje të shkollimit ose nxënësit braktisës. Në disa shkolla, rastet në rrezik për braktisje të shkollimit të cilat i identifikojnë mësimitdhënësit fillimisht trajtohen nga vetë shkolla. Mësimitdhënësit së bashku me drejtorin e shkollës identifikojnë mënyrat e kontaktimit të prindit të nxënësit që ka munguar për një periudhë kohore në shkollë. Zakonisht kjo periudhë kohore gjatë të cilës mungon nxënësi pa arsye në shkollë nuk është e përcaktuar. Andaj, i mbetet mësuesit apo kujdestarit që të vendosë se kur nxënësi të trajtohet si rast potencial për braktisje apo mosvijueshmëri të rregullt. Kontaktimi i prindërve të këtyre nxënësve zakonisht bëhet me anë të telefonit nga ana e mësimitdhënësit, ose përmes nxënësve të tjerë të lagjes. Në raste shumë të rralla mësimitdhënësit iniciojnë ndonjë vizitë te prindërit e nxënësit të tillë.

Nëse përpjekjet e shkollës për të rikthyer nxënësin në shkollë dështojnë, ndonjëherë shkolla direkt e referon rastin te institucionet tjera. Zakonisht, këto raste shkollat i referojnë në QPS, dhe nëse implikohen edhe deliktet, rastet i referojnë edhe në polici. Për të referuar rastet zbatohen procedurat e referimit të institucioneve përkatëse në të cilat referohen këta nxënës. Organi i kujdestarisë, që është QPS-ja, trajton rastin dhe e monitoron gjatë gjithë kohës së trajtimit. Kryesisht, brenda këtij institucioni ofrohet këshillimi i nxënësve dhe i prindërve të tyre. Nëse është e nevojshme ky institucion e referon rastin për shërbime të institucioneve tjera. Megjithatë, kjo praktikë e referimit dhe trajtimit nuk zbatohet rregullisht.

Një problem shqetësues për shkollat paraqesin nxënësit të cilët zhvendosen në shkolla të tjera, komuna të tjera, apo në shtete të tjera. Nxënësit e tillë marrin fletëkalimet nga shkolla paraprake, mirëpo, kjo shkollëpothuajse kurrë nuk merr informatë kthyesë për regjistrimin e tyre në shkollë tjetër. Për këtë, nxënësit e tillë nuk dihet a janë regjistruar në shkollë tjetër apo kanë braktisur shkollimin.

Te rastet e nxënësve në rrezik për braktisje apo braktisës të shkollimit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, mësimitdhënësi apo drejtori e referon rastin te ndërmjetësuesi në komunitet nëse është në dispozicion në atë shkollë. Ndërmjetësuesi në komunitet merret me identifikimin e shkaqeve të ndërprerjes së vijimit të shkollimit, këshillimin e nxënësit dhe prindërve të tij. Në rast se nxënësi ka nevojë për ndihmë në lidhje me procedura të ndryshme administrative në institucione të tjera apo në shkollë, ndërmjetësuesi në komunitet e këshillon, i ofron informacionet e duhura dhe në rast nevojë e asiston në këto procedura administrative. P.sh., ka raste që nxënësi ka qenë i sëmurë dhe prindërit e tij/saj nuk kanë qenë në dijeni që duhet të merret vërtetimi nga mjeku për gjendjen shëndetësore të nxënësit dhe ky vërtetim të dorëzohet në shkollë. Ndërmjetësuesi në komunitet i informon prindërit e nxënësit për mënyrën e nxjerrjes së vërtetimit mjekësor dhe dorëzimin e vërtetimit në shkollë. Në të njëjtën kohë, ndërmjetësuesi e monitoron nxënësin gjatë gjithë kohës deri sa të rivendoset vijueshmëria e tij e rregullt në shkollë.

Mirëpo, ka raste që raportimi i nxënësve në rrezik për braktisje të shkollimit bëhet me vonesë. Kjo shkakton vështirësi të mëdha në rikthimin e tyre në shkollë. Për shkak të kohës së gjatë të

mosvijueshmërisë, nxënësit e tillë mbeten të panotuar. Aq më tepër këtyre nxënësve nuk u mundësohet vijimi i mësimin të përshtetshëm. Si pasojë, këta nxënës humbin një vit shkollor. Rikthimin e tyre në shkollë e vështirëson fakti se këta fëmijë duhet të kthehen në një klasë tjetër si përsëritës ku potencialisht mund të hasin në vështirësi në ambientimin e tyre në klasë. Shembull konkret është rasti në Shkollën fillore të mesme të ulët “Naim Frashëri” në fshatin Zaskok të komunës së Ferizajt, ku 22 nxënës kryesisht nga komuniteti ashkali kanë braktisur shkollimin në muajt e parë të vitit shkollor 2018/2019. Brenda këtij viti shkollor, dy nxënës është arritur që të kthehen në shkollë në klasën e 8-të dhe të 9-të me ndihmën e qendrës mësimore në fshatin Dubravë të kësaj komune. Ende 20 nxënës kanë mbetur jashtë shkollës, prej të cilëve 11 nxënës do të duhej të kishin vijuar klasën e parë. Këta nxënës që kanë mbetur jashtë shkollës janë integruar në qendrat mësimore, përdorja riintegrimi i tyre në shkollimin e rregullt nuk është mundësuar. Aq më tepër, në këtë lokacion nuk ka pasur ndërmjetësues në komunitet për të asistuar në këto raste gjatë këtij viti shkollor.

Për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të braktisjes së shkollimit nga nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, një praktikë e zakonshme e ndërmjetësuesve në komunitet është kontrollimi i listave të notimit. Këta ndërmjetësues identifikojnë nxënësit e panotuar nga radhët e këtyre komuniteteve dhe iniciojnë kontaktimin e familjarëve të tyre.

Ka shkolla të cilat raportojnë që praktikojnë lehtësime për rikthim në shkollë për nxënësit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të cilët kanë ndërprerë vijimin e shkollimit. Këto lehtësime kanë të bëjnë me tolerimet që bëhen në aspektet procedurale në shkollë, në mospërfundime nga shkolla për numër shumë të lartë të mungesave etj. Kjo krijon pakënaqësi të nxënësit dhe prindërit e grupeve të tjera etnike për anueshmëri dhe zbatim të pabarabart të rregullave për nxënësit e të gjitha grupeve etnike.

Shkollat gjithashtu raportojnë që hasin në vështirësi në evidentimin e përkatësisë etnike të disa nxënës nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Zyrtarët e shkollave raportojnë që evidentimi i përkatësisë etnike në dokumente është i domosdoshëm në sholla. Ka raste të prindërve të këtyre nxënësve nga këto komunitete të cilët deklarohen se nuk janë në dijeni se cilit komunitet etnik i përkasin. Kjo pamundëson një pasqyrim korrekt të përkatësisë etnike në statistikat e shkollës, komunale dhe nacionale.

Pjesa dërmuese e rasteve të braktisjes së shkollës dhe në rrezik për të braktisur shkollimin nuk parashtrohen në EPRBM-të shkollore. Siç u cek më lartë, rastet nuk identifikohen dhe nuk trajtohen ose, te rastet e identikuara, mësuesi apo kujdestari i klasës në koordinim me drejtorin e shkollës vendosin se si të trajtojnë rastin, ku ta referojnë dhe si ta monitorojnë. Po ashtu, pjesa dërmuese e rasteve nuk parashtrohen as në EPRBM-të komunale. Në shumicën dërmuese të rasteve EPRBM-të komunale nuk janë në dijeni. Aq më tepër, regjistrimi i rasteve në SPH është tejet i mangët. Dokumentimi bëhet nga institucioni përkatës i cili e trajton rastin sipas procedurave administrative të atij institucioni. DKA-të raportojnë që nuk ka kapacitete të mbikëqyrjes së rasteve të trajtimit të braktisjes apo në rrezik të braktisjes as për rastet të cilat raportohen në DKA. Në mungesë të regjistrimit të rasteve në SPH dhe të raportimit të rasteve të braktisjes dhe në rrezik për braktisje të shkollimit në DKA, këto drejtori nuk kanë mundësi të

përpilojnë statistika të sakta. Regjistrimi në SPH të rasteve të paregjistruara në shkollë është pothuajse i pamundur për shkak të ngecjeve në identifikimin e tyre.

Kryesisht praktikohet që vetëm rastet e rënda të cilat përfshijnë jo vetëm braktisjen e shkollimit por edhe deliktet të referohen në institucione të tjera përkatëse siç janë institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë. Ndërsa, rastet të cilat nuk kanë të bëjnë me delikte shpeshherë nuk referohen, nuk trajtohen dhe nuk monitorohen.

Regjistrimi i rasteve në modulën e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm (SPH) në SMIA

Shkollat janë të mandatuara që të identifikojnë rastet në rrezik për braktisje të shkollimit me anë të instrumentit për identifikim të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës. Zbatimi i këtij instrumenti nuk është në nivel të kënaqshëm. Stafi në shkolla më tepër aplikon identifikimin e këtyre rasteve në baza ditore duke përcjellë vijueshmërinë e nxënësve. Rastet të cilat grumbullojnë një numër të konsiderueshëm të mungesave raportohen gojarisht ose me shkrim te drejtori. Por, zakonisht këto raste nuk praktikohet që të regjistrohen në SPH.

Meqenëse nuk praktikohet zbatimi i instrumentit për identifikim të nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës, në SPH mungojnë këto informata dhe rrjedhimisht mungon pasqyra e përgjithshme e shkollës për nivelin e braktisjes dhe rrezikut të braktisjes së shkollimit.

Sa i përket rasteve të braktisjes së shkollimit, e sidomos të nxënësve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, zakonisht evidentohen në administratën e shkollës si nxënës të panotuar dhe nuk regjistrohen në SPH. Po ashtu, ndodh që rastet e braktisjes së shkollimit nuk raportohen me kohë. Kjo ndikon që rastet e tilla të humbin një vit shkollor për shkak të mungesës relativisht të gjatë në shkollë dhe mungesës së ofrimit të mësimin të përshpejtuar. Shembull konkret, siç u përmend më lartë, janë rastet e nxënësve të shkollës fillore “Naim Frashëri” në fshatin Zaskok.

Rastet e mosregjistrimit në klasë të parë nuk regjistrohen në SPH. Kjo sidomos është e shprehur për fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo ndodh për dy arsye. Së pari, për shkak se këta fëmijë të cilët e kanë mbërrirë moshën për regjistrim në klasë të parë por nuk paraqiten në shkollë për t'u regjistruar. Rrjedhimisht, shkolla nuk ka kurrfarë informate për këta fëmijë. Së dyti, nxënësit të cilët fillojnë klasën e parë, mirëpo e braktisin shkollimin qysh në fillim të klasës së parë, nuk konsiderohen si braktisës të shkollimit por si fëmijë që duhet të presin një vit për të arritur pjekurinë psiko-fizike për të filluar shkollimin në klasë të parë. Rrjedhimisht, këta nxënës nuk raportohen si braktisës të shkollimit dhe rastet e tyre nuk regjistrohen në SPH.

Ndër arsyet e raportuara nga shkolla për mungesë të regjistrimit të rasteve në SPH janë:

- Mungesa e njohurive dhe shkathtësive kompjuterike të mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave
- Mungesa e njohurive për SPH-në
- Drejtorët e shkollave të emëruar rishtazi të cilët nuk kanë pasur rast të vijojnë trajnime për përdorimin e SPH-së

- Mësimdhënësit e rekrutuar rishtazi të cilët nuk kanë pasur rast të vijojnë trajnime për përdorimin e SPH-së
- Hezitimi për të regjistruar rastet në SPH për shkak të mundësisë së identifikimit të shkollës si “shkollë e dështuar”

Një arsye tjetër relevante për nxënësit nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është mungesa e deklaramit të identitetit të tyre etnik në disa raste. Te këto raste, të dhënat e regjistruara në SPH nuk paraqesin pasqyrën reale të braktisjes dhe rrezikut të braktisjes së shkollimit te këto komunitete.

Siç është cekur edhe më lartë, shkollat praktikojnë që të regjistrojnë në SPH kryesisht rastet e braktisjes apo në rrezik për braktisje të shkollimit që në të njëjtën kohë janë të përfshira në ndonjë delikt dhe që janë referuar në institucionet përkatëse të sigurisë, kujdestarisë dhe drejtësisë.

Mungesa e regjistrimit të rasteve në SPH qëjanë në rrezik për të braktisur shkollimin, një pjese të numrit të rasteve që kanë braktisur shkollimin dhe rasteve që nuk janë regjistruar në shkollë krijon një boshllëk në aspektin e të kuptuarit të braktisjes së shkollës dhe mosregjistrimit në shkollë. Kjo e pamundëson analizën e situatave potenciale që çojnë në braktisje të shkollimit dhe mungesë të të dhënave të nevojshme për zhvillim të politikave përkatëse. Rrjedhimisht, kjo çon në politika joadekuate të adresimit të braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

REKOMANDIMET

<p>Të themelohen EPRBM-të në të gjitha komunat dhe në të gjitha shkollat dhe të sigurohet funksionaliteti i tyre</p>	<ul style="list-style-type: none"> • MASHT-i të verifikojë themelimin e tyre • Roli i EPRBM-ve të publikohet në webfaqet e komunave • Të bëhet transparente lista e anëtarëve të EPRBM-ve komunale dhe të publikohet kjo listë në webfaqen e komunës • Të përditësohet kjo listë rregullisht për çdo ndryshim që e pëson • EPRBM-të komunale dhe EPRBM-të e shkollave të mbajnë mbledhje të rregullta • Të angazhohen studentët praktikantë në punët administrative dhe organizative të mbledhjeve të EPRBM-ve komunale • Të ofrohet stimulim material dhe moral për shkollat dhe komunat të cilat janë të suksesshme në adresimin e braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë
<p>Të zgjerohet përfaqësimi i akterëve të rëndësishëm në EPRBM-të komunale</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përfshihen ndërmjetësuesit në komunitet në EPRBM-të komunale në të gjitha komunat • Të angazhohen në EPRBM-të komunale ndërmjetësuesit në komunitet nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian • Të përfshihen në EPRBM-të komunale të gjitha OShC-të aktive të cilat merren me çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe me çështjet e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë • Të përfshihet psikologu në EPRBM-të komunale për të ofruar vlerësime psikologjike dhe trajtime të nxënësve të cilët kanë vështirësi në të nxënë dhe në adaptim në ambientin shkollor që potencialisht janë në rrezik për braktisje të shkollimit
<p>Të ngritët niveli dhe cilësia e trajtimit të rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve që janë në rrezik për të braktisur shkollimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Menaxherët e rastit të angazhohen në mënyrë aktive për të trajtuar rastet • Të bëhet plani i trajtimit të rasteve në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore dhe mekanizmat përkatës • Psikologu të ofrojë vlerësime psikologjike dhe trajtim psikologjik për nxënësit të cilët kanë vështirësi në të nxënë dhe në adaptim në ambientin shkollor • Të angazhohen në shkolla studentët e pedagogjisë, edukimit dhe psikologjisë për të ofruar ndihmë në mësimnxënie dhe aktivitete të tjera për integrim social të fëmijëve të riintegruar në shkollë dhe fëmijëve që janë në rrezik për të braktisur shkollimin • Të ofrohet trajnim për mesimdhënësit për ndjeshmërinë kulturore në mesimdhënie për grupe të ndryshme kulturore dhe etnike, me një fokus të veçantë për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

	<ul style="list-style-type: none"> • Të ndërpriten praktikat e ofrimit të shpërblimeve materiale te nxënësit për të stimuluar vijimin e shkollimit, me përfshirje të mjeteve shkollore dhe veshmbathjes
<p>Të përmirësohet identifikimi, referimi dhe monitorimi i rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për braktisje të shkollimit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • EPRBM-të e shkollave të bashkëpunojnë ngushtë me institucionet përkatëse për identifikimin e fëmijëve të paregjistruar në shkollë siç janë zyrat e ofiqarisë, OShC-të që merren me çështje të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe me çështje të mosregjistrimit në shkollë • Të referohen rastet në shërbimet përkatëse menjëherë sapo të identifikohen • Të gjitha rastet që nuk mund të trajtohen në nivel të shkollës të paraqiten për shqyrtim në EPRBM-të komunale • EPRBM-ja komunale të mbahet e informuar për të gjitha rastet e referuara përmes SPH-së • Të regjistrohen në SPH të gjitha informatat e duhura që kanë të bëjnë me identifikim, referim, trajtim dhe monitorim • Të krijohet një mekanizëm brenda SMIA-s që do të i mundësonte shkollës paraprake përcjelljen e nxënësve të cilët kalojnë në shkollë tjetër
<p>Të përmirësohet dokumentimi në SPH i rasteve të braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rasteve në rrezik për të braktisur shkollimin</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të ofrohet trajnim i vazhdueshëm për anëtarët e EPRBM-ve shkollore për të dokumentuar në SPH të gjitha rastet e braktisjes së shkollimit, mosregjistrimit në shkollë dhe rastet në rrezik të braktisjes së shkollimit • Të regjistrohen në SPH të gjitha rastet e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë • Me anë të listës së treguesve të rrezikut të bëhet identifikimi i rregullt i rasteve që janë në rrezik për të braktisur shkollimin dhe të regjistrohen në SPH • Në SPH të regjistrohen të gjitha informatat që kanë të bëjnë me identifikimin, referimin, trajtimin dhe monitorimin e rasteve • Organet kompetente të bëjnë inspektimin e rregullt të dokumentimit në SPH
<p>Të ngritët niveli i komunikimit në mes të EPRBM-ve dhe komunitetit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të funksionalizohet një linjë telefonike në DKA-të komunale për të ofruar informata për qytetarët që ballafaqohen me vështirësi në regjistrimin apo rikthimin e fëmijëve në shkollë, si dhe anasjelltas, të jetë në dispozicion për qytetarët për të lajmëruar rastet e braktisjes së shkollimit apo mosregjistrimit në shkollë nga komuniteti ku jetojnë ose më gjerë • Të realizohen takime periodike të EPRBM-ve shkollore dhe komunale në lagjet që kanë nivel të lartë të braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë p.sh. lagjet me banorë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian dhe që kanë raste të tilla në nivel relativisht të lartë

<p>Të realizohen aktivitete sensibilizuese për çështjen e braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë dhe aktivitete promovuese për EPRBM-të</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të sensibilizohen qytetarët për prezencën e çështjes së braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë • Të informohen qytetarët për linjën telefonike në dispozicion për qytetarët për ofrim të informatave përkatëse dhe për lajmërim të rasteve të braktisjes së shkollimit dhe mosregjistrimit në shkollë • Të realizohen aktivitete në komunitet për rolin e EPRBM-ve komunale dhe EPRBM-ve të shkollës
<p>Inspektorati i arsimit të inspekton aktivitetet e EPRBM-ve komunale dhe EPRBM-vetë shkollës</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktohen kriteret dhe procedurat e ndëshkimit për mospërmbushje të plotë të funksionimit të EPRBM-ve komunale dhe EPRBM-ve të shkollës • Të bëhen inspektime të rregullta në çdo komunë dhe çdo shkollë • Në inspektimin e EPRBM-ve të përfshihen edhe treguesit e matur në komunitet siç është numri i fëmijëve të identifikuar në komunitet të cilët nuk e vijnë shkollimin
<p>MAShT-i të bëjë analiza dhe raportime të rregullta mbi të dhënat dhe informatat e mbledhura në SPH</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të analizohen të dhënat dhe informatat në SPH në mënyrë periodike • Të publikohen raporte të analizës së këtyre të dhënave dhe informatave që përfshinë raportimin e të gjeturave në bazë të moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, komunave, etj. • Këto raporte të përmbajnë tregues të bazuar në të dhënat kualitative dhe kuantitative • Të shpërndahen këto raporte në të gjitha komunat, në të gjitha shkollat dhe teOSHC-të relevante • Këto raporte të përfshijnë shembuj të rasteve të trajtuar në mënyrë të suksesshme duke identifikuar shkollat dhe komunat përkatëse



ROMA INTEGRATION 2020
Regional Cooperation Council